



BULETIN MUJOR

KORRIK 2026



PËRMBAJTJA

- AKSK zhvilloi Ushtrimin Kombëtar Simulues për Menaxhimin e Krizave Kibernetike
- Shqipëria bëhet vendi i parë në rajon që anëtarësohet në ICCSW
- AKSK zhvilloi dëgjesa publike për ndryshimet në projektligjin për sigurinë kibernetike
- Shqipëria në Mekanizmin Global të OKB-së për TIK-un dhe sigurinë ndërkombëtare
- AKSK shpall ekipin kombëtar që do të përfaqësojë Shqipërinë në ECSC 2026

AKSK zhvilloi Ushtrimin Kombëtar Simulues për Menaxhimin e Krizave Kibernetike



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike organizoi Ushtrimin Kombëtar Simulues për Menaxhimin e Krizave Kibernetike, me pjesëmarrjen e institucioneve shtetërore dhe operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Përmes një skenari simulues, u testuan gatishmëria, koordinimi ndërinstitucional dhe reagimi ndaj incidenteve kibernetike me ndikim të gjerë, me synim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve jetike.



Shqipëria bëhet vendi i parë në rajon që anëtarësohet në ICCSW

Shqipëria është anëtarësuar në International Coalition on Cyber Security Workforces (ICCSW), duke u bërë vendi i parë në rajon që i bashkohet këtij koalicioni ndërkombëtar, të udhëhequr nga Departamenti Britanik për Shkencë, Inovacion dhe Teknologji (DSIT).

Anëtarësimi mundëson shkëmbimin e ekspertizës dhe praktikave më të mira, zhvillimin e standardeve të përbashkëta dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në fushën e sigurisë kibernetike. Ky bashkëpunim mbështet gjithashtu synimin për ta pozicionuar Shqipërinë si një qendër rajonale të dijes dhe ekspertizës në këtë fushë.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039

AKSK zhvilloi dëgjesa publike për ndryshimet në projektligjin për sigurinë kibernetike

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi dëgjesat publike mbi ndryshimet e propozuara në ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe sektorit bankar.

Gjatë takimeve u prezantuan risitë e parashikuara në projektligj, ndërsa pjesëmarrësit ndanë komentet dhe sugjerimet e tyre. Ndryshimet synojnë forcimin e mekanizmave të mbrojtjes kibernetike, rritjen e kapaciteteve për parandalimin dhe reagimin ndaj incidenteve, qartësimin e detyrimeve të operatorëve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së ekosistemit kibernetik në vend.



Shqipëria në Mekanizmin Global të OKB-së për TIK-un dhe sigurinë ndërkombëtare

Shqipëria mori pjesë në sesionet plenare të Mekanizmit Global për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, të zhvilluar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

Gjatë diskutimeve u paraqit vlerësimi i Shqipërisë mbi kërcënimet kibernetike në rritje, përfshirë sulmet ndaj institucioneve publike dhe infrastrukturave kritike, dezinformimin dhe rreziqet nga keqpërdorimi i Inteligjencës Artificiale. Shqipëria rikonfirmoi angazhimin për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sjelljen e përgjegjshme të shteteve në hapësirën kibernetike.

AKSK shpall ekipin kombëtar që do të përfaqësojë Shqipërinë në ECSC 2026

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike ka përmbyllur procesin e përzgjedhjes së ekipit kombëtar që do të përfaqësojë Shqipërinë në European Cyber Security Challenge (ECSC) 2026. Pas përfundimit të fazave kualifikuese, u përzgjedhën 10 finalistët e Team Albania, bazuar në rezultatet, vlerësimin e trajnerëve dhe aftësitë e tyre teknike.

Ekipi shqiptar do të garojë nga data 12 deri më 16 tetor 2026 në Bochum të Gjermanisë, përballë ekipeve kombëtare nga Europa, në sfida që përfshijnë kriptografinë, sigurinë e aplikacioneve web, reverse engineering dhe forensics.

